




*Nr. 73 prot
Dt. 12/12/2018*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



V E N D I M

Nr. 8 Datë 11.12.2018

**PËR MOSMIRATIM NË PARIM TË KËRKESËS PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR
PËR ENERGJI ELEKTRIKE SUBJEKTIT “KËRNAJA POWER” SH.P.K**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, të nenit 50, pika 2, të ligjit nr.6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr.111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika1/ c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni”, për paisjen me autorizim(miratim në parim) të subjektit “KËRNAJA POWER” SH.P.K., me propozim të A.B.U Drin- Bunë, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

V e n d o s i:

1-Mosmiratimin në parim të kërkesës së subjektit “KËRNAJA POWER” SH.P.K me administrator Z. Gëzim ISLAMI, për përdorim të burimit ujor **Përroi i Madh**, degë e Lumit të Bushtricës, për prodhim energjie elektrike (HEC Kërnaja 2), në fshatin Kërnajë, Njësia Administrative Tropojë, Bashkia Tropojë, Qarku Kukës.

2- Kjo kërkesë nuk është miratuar për arsyen se ndikon negativisht në mjedis.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETAR

Raimonda GURI



KRYETAR

Cesk MULLAJA

